



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 4.9.2023

Nr: 747

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA E LIRISË”, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET E E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023

Sot më datë 4.9.2023, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur në datë 1.9.2023, me:

Kërkues: Partia politike “Partia e Lirisë”, me kryetar z. Ilir Metaj.

Objekti: Regjistrimi i partisë politike “Partia e Lirisë” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023

Baza ligjore: Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 186, datë 11.8.2023, ka caktuar datën 24 Shtator 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës.

“Partia e Lirisë”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Ilir Metaj, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, që do të zhvillohen më datë 24 Shtator 2023.

Data: 4.9.2023 Nr:747
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia e Lirisë”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023”.

Nga partia politike “Partia e Lirisë” është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 30.8.2023, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia e Lirisë”, me iniale “PL”, me kryetar z. Ilir Metaj, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia e Lirisë” me shkronja nistore “PL”, me adresë Rruga “Sami Frashëri”, Godina 20/10, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Ilir Metaj, me adresa, Rruga “Sami Frashëri”, Godina 20/10 Tiranë;
- c) Financieri i partisë është z. Georgos Gostivishti, me adresë, Rruga “Sami Frashëri”, Godina 20/10, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Altin Kaziaj, dhe z. Fjoraldi Guri, me adresë Rruga “Sami Frashëri”, Godina 20/10, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia e Lirisë”, respekton afatin kohor të parashikuar në nenin 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga “Partia e Lirisë”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenin 64, pika 2 dhe nenin 92 /2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 1, datë 18.1.2023, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, dhe vendimit nr. 28 datë 16.8.2023, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për Kryetar në Bashkinë Kukës, që do të zhvillohen më datë 24 Shtator 2023”,

VENDOS:

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia e Lirisë”, me Kryetar z. Ilir Metaj, me shkronjat nistore “PL”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjeshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI